



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

RREGULLORE (QRK) NR. 27/2018 PËR SHËRBIMIN E KOMUNIKIMIT QEVERTAR ME PUBLIKUN¹

REGULATION (GRK) NO. 27/2018 ON THE GOVERNMENT PUBLIC COMMUNICATION SERVICE²

UREDBE (VRK) BR. 27/2018 O SLUŽBI ZA KOMUNIKACIJU VLADE JAVNOŠĆU³

¹ Rregullore (QRK) Nr.27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, është miratuar në mbledhjen e 80-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.01/80, datë 18.12.2018.

² Regulation (GRK) No.27/2018 on the Government Public Communication Service, was approved on 80th meeting of the Government of Kosovo, with the decision No.01/80, date 18.12.2018.

³ Uredbe (VRK) Br.27/2018 o Službi za Komunikaciju Vlade Javnošću , usvojen je na 80 sednicu Vlade Kosova, odlukom br. 01/80, datum 18.12.2018.

<p>Qeveria e Republikës së Kosovë</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 5 dhe 26 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, (Gazeta Zyrtare nr. 88, 25.11.2010), nenet 17, 53 dhe 56 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.82, 21.10.2010), dhe nenit 19, paragrafi 6, nën-paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011(Gazeta Zyrtare, nr. 15, 12.09.2011),</p> <p>Miratton:</p> <p>RREGULLORE (QRK) NR. 27/2018 PËR SHËRBIMIN E KOMUNIKIMIT QEVERTAR ME PUBLIKUN</p> <p>I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Me këtë rregullore përcaktohet funksionimi i një sistemi koherent dhe të koordinuar për komunikimin qeveritar me publikun.</p>	<p>The Government of the Republic of Kosovo</p> <p>Pursuant to Article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, based on Articles 5 and 26 of the Law No. 03/L-215 on Access to Public Documents, (Official Gazette No. 88, 25.11.2010), Articles 17, 53 and 56 of the Law No. 03/L-189 on State Administration of the Republic of Kosovo (Official Gazette No. 82, 21.10.2010), and Article 19, paragraph 6, subparagraph 2 of Regulation No. 01/2007 of Rules and Procedure of the Government (Official Gazette, No. 15, 12.09.2011),</p> <p>Approves:</p> <p>REGULATION (GRK) NO. 27/2018 ON THE GOVERNMENT PUBLIC COMMUNICATION SERVICE</p> <p>I. GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>This Regulation sets out the functioning of a coherent and coordinated system for government public communication.</p>	<p>Vlada Republike Kosova</p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosovo, u skladu sa članovima 5 i 26 Zakona br. 03/L-215 o uvidu u javnim dokumentima, (Službeni list br. 88, 25.11.2010.), članovima 17, 53 i 56 Zakona br. 03/L-189 o državnoj administraciji Republike Kosovo (Službeni list br. 82, 21.10.2010.) i članom 19. stav 6. tačka 2. Pravilnika o radu Vlade Republike Kosovo, br. 09/2011 (Službeni list, br. 15, 12.09.2011.),</p> <p>Usvaja:</p> <p>UREDBU (VRK) BR. 27/2018 O SLUŽBI ZA KOMUNIKACIJU VLADE S JAVNOŠĆU</p> <p>I. OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Ovom uredbom se utvrđuje funkcionisanje koherentnog i koordiniranog sistema za komunikaciju Vlade s javnošću.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e kësaj Rregullore janë të detyrueshme për të gjitha institucionet qeveritare në nivel qendror dhe lokal dhe përfaqësuesit e mediave, të cilët akreditohen për të përcjellur aktivitetet e këtyre institucioneve.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this Regulation are binding on all Government institutions at central and local level, and media representatives who are accredited to cover activities of these institutions.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Odredbe ove Uredbe su obavezujuće za sve vladine institucije na centralnom i lokalnom nivou i predstavnike medija koji su akreditovani za praćenje aktivnosti ovih institucija.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Parimet e komunikimit</p> <p>1. Parimet e komunikimit qeveritar me publikun janë:</p> <p>1.1. Komunikim i hapur me publikun – institucionet qeveritare sigurohen që puna e tyre është e hapur për publikun. Çdo informacion që nuk i nënshtrohet kufizimeve ligjore është publik;</p> <p>1.2. Komunikim objektiv dhe i paanshëm - institucionet qeveritare komunikojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme, duke ofruar informacione të sakta dhe të besueshme për publikun;</p> <p>1.3. Komunikim i qartë, i përgjegjshëm dhe në kohë – institucionet qeveritare i ofrojnë publikut informacione të qarta, të konfirmuara dhe në kohë, si dhe krijojnë marrëdhënie të mira me mediat dhe publikun;</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Communication principles</p> <p>1. Principles of government public communication are:</p> <p>1.1. Open public communication – government institutions ensure that their work is open to the public. Any information that is not subject to legal restrictions shall be deemed to be public;</p> <p>1.2. Objective and impartial communication - government institutions communicate in an objective and impartial manner, providing accurate and reliable information to the public;</p> <p>1.3. Clear, responsible and timely communication – government institutions provide the public with clear, confirmed and timely information, as well as establish good relations with media and public;</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Principi komunikacije</p> <p>1. Glavni principi komunikacije Vlade s javnošću su:</p> <p>1.1. Otvorena komunikacija s javnošću – Vladine institucije obezbeđuju da je njihov rad otvoren za javnost. Sve informacije koje nisu predmet zakonskih ograničenja su javne;</p> <p>1.2. Objektivna i nepristrasna komunikacija – Vladine institucije komuniciraju objektivno i nepristrasno, pružajući tačne i pouzdane informacije za javnost;</p> <p>1.3. Jasna, odgovorna i avovremena komunikacija – Vladine institucije pružaju javnosti jasne, potvrđene i pravovremene informacije, kao i uspostavaju dobre odnose sa medijima i javnošću;;</p>

<p>1.4. Komunikim përfshirës - institucionet qeveritare sigurojnë që përmes komunikimit, t'ia mundësojnë publikut pjesëmarrjen aktive në hartimin e politikave dhe legjislacionit. Publikut i sigurohet e drejta për të shprehur pikëpamjet e tij dhe për të komunikuar me vendimmarrësit;</p> <p>1.5. Komunikim aktiv – Shërbimi i Komunikimit Qeveritar me publikun nxitë aktivitetet e komunikimit në kohën e duhur, në mënyrë që publiku të informohet për të drejtat dhe përgjegjësitë e tij;</p> <p>1.6. Komunikim koherent – Komunikimi qeveritar me publikun duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i koordinuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Shërbimi i Komunikimit Qeveritar me Publikun – nënkupton nëpunësit civil dhe zëdhënësit, përgjegjës për komunikim qeveritar me publikun.</p> <p>1.2. Zyra për Komunikim me Publikun, në tekstin e mëtejme ZKP – nënkupton Departamentin / Divizionin / Njësinë në</p>	<p>1.4. Inclusive communication – government institutions ensure that, through communication, public's active involvement in drafting policies and legislation is enabled. The public shall be provided with the right to express its viewpoints and communicate with decision-makers;</p> <p>1.5. Active communication – The Government Public Communication Service promote communication activities and do so in due time, in order for the public to be informed of its rights and responsibilities;</p> <p>1.6. Coherent communication – Government public communication shall be reasonable and coordinated.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Definitions</p> <p>1. Terms used in this Regulation shall have the following meanings:</p> <p>1.1. The Government Public Communication Service – shall mean civil servants and spokespersons, responsible for government communication with public.</p> <p>1.2. Public Communication Office, hereinafter PCO – shall mean the relevant Department/Division/Unit</p>	<p>1.4. Inkluzivna komunikacija -Vladine institucije obezbeđujuda putem komunikacije omogućavaju javnosti aktivno učestvovanje u izradi politika i zakonodavstva. Javnosti se obezbeđuje pravo da izrazi svoja mišljenja i da komunicira sa nosiocima odluka;</p> <p>1.5. Aktivna komunikacija – Služba za komunikaciju Vlade s javnošću podstiče komunikacijske aktivnosti i da to radi pravovremeno, kako bi javnost bila upoznata sa njenim pravima i odgovornostima;</p> <p>1.6. Koherentna komunikacija – komunikacija Vlade s javnošću treba biti razumna i koordinirana.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Definicije</p> <p>1. Izrazi koji se koriste u ovoj uredbi imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. Služba za komunikaciju Vlade s javnošću – podrazumeva civilne službenike/ce i portparole/ke, odgovorne za komunikaciju Vlade s javnošću.</p> <p>1.2. Kancelarija za Javnu Komunikaciju, u daljem tekstu KJK – podrazumeva odgovarajući Departman/Diviziju/ Jedinicu u okviru</p>
--	--	---

<p>kuadër të institucionit, përgjegjës për komunikim qeveritar me publikun</p> <p>1.3. Trupi Koordinues Qeveritar – nënkupton Trupin Koordinues Qeveritar për Komunikim me Publikun</p> <p>1.4. Institucione qeveritare në nivel qendror dhe lokal - nënkuptojnë Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive qeveritare apo njësitë përkatëse në vartësi të Zyrës së Kryeministrit apo ministrive përkatëse dhe komunat.</p> <p>II. FUNKSIONET E SHËRBIMIT TË KOMUNIKIMIT QEVERTAR ME PUBLIKUN</p> <p>Neni 5 Zëdhënësi/ja i/e Qeverisë</p> <p>1. Zëdhënësi/ja i/e Qeverisë emërohet nga Kryeministri/ja dhe shërben si këshilltar kryesor profesional lidhur me çështje të komunikimit për Kryeministrin/en, Zëvendëskryeministrat dhe Qeverinë në tërësi.</p> <p>2. Detyrat e zëdhënësit/es të Qeverisë janë si në vijim:</p>	<p>within the institution, responsible for government public communication.</p> <p>1.3. Government Coordination Body – shall mean the Government Coordination Body for Public Communication.</p> <p>1.4. Government institutions at central and local level – shall mean the Office of the Prime Minister and Ministries, executive government agencies or relevant units subordinate to the Office of the Prime Minister or relevant ministries and municipalities.</p> <p>II. FUNCTIONS OF THE GOVERNMENT PUBLIC COMMUNICATION SERVICE</p> <p>Article 5 Spokesperson of the Government</p> <p>1. Spokesperson of the Government shall be appointed by the Prime Minister and shall serve as the main professional advisor on issues of communication for the Prime Minister, Deputy Prime Ministers and the Government in general;</p> <p>2. Duties of the Spokesperson of the Government shall be as follows:</p>	<p>institucija, odgovorne za komunikaciju Vlade s javnošću</p> <p>1.3. Koordinaciono telo Vlade – podrazumeva Koordinaciono telo Vlade za komunikaciju s javnošću</p> <p>1.4. Vladine institucije na centralnom i lokalnom nivou – podrazumevaju Kancelariju Premijera i Ministarstva, Vladine izvršne agencije ili odgovarajuće podređene jedinice Kancelarije Premijera ili odgovarajućih Ministarstava i Opština.</p> <p>II. FUNKCIJE SLUŽBE ZA KOMUNIKACIJU VLADE S JAVNOŠĆU</p> <p>Član 5 Portparol/ka Vlade</p> <p>1. Portparola/ku Vlade imenuje Premijer/ka i on/ona služi kao glavni/a stručni/a savetnik/ca za pitanja komunikacije za Premijera/ku, Zamenike/ce premijera/ke i Vladu u celini;</p> <p>2. Dužnosti portparola/ke Vlade su sledeće:</p>
--	---	---

<p>2.1. Siguron prezantimin medial të aktiviteteve zyrtare të Kryeministrit/es dhe të Qeverisë, brenda dhe jashtë vendit;</p> <p>2.2. Merr pjesë në përgatitjen e deklaratave dhe fjalimeve të Kryeministrit/es dhe të Qeverisë;</p> <p>2.3. Së bashku me Drejtorin/eshën e Zyrës për Komunikim me Publikun në Zyrën e Kryeministrit, në tekstin e mëtejme ZKP-ZKM, siguron që ministritë të japin kontributin e tyre për prezantimin e përgjithshëm të politikave dhe aktiviteteve qeveritare;</p> <p>2.4. Ndhmon në prezantimin e politikave dhe aktiviteteve ministrore në mënyrë profesionale dhe efektive.</p>	<p>2.1. Ensures media coverage of official activities of the Office of the Prime Minister and the Government, domestically and abroad;</p> <p>2.2. Takes part in preparation of statements and speeches of the Prime Minister and of the Government;</p> <p>2.3. Together with the Director of the Public Communication Office in the Office of the Prime Minister, hereinafter PCO-OPM, ensures that ministries provide their contribution for general presentation of government policies and activities;</p> <p>2.4. Assists in the presentation of ministerial policies and activities in a professional and effective manner.</p>	<p>2.1. Obezbeđuje medijsku prezentaciju zvaničnih aktivnosti Premijera/ke i Vlade, kako unutar tako i izvan zemlje;</p> <p>2.2. Učestvuje u pripremi izjava i govora Premijera/ke i Vlade;</p> <p>2.3. Zajedno sa Direktorom/kom Kancelarije za Javnu Komunikaciju u Kancelariji Premijera, u daljem tekstu KJK-KP, obezbeđuje da ministarstva daju svoj doprinos celokupnoj prezentaciji vladinih politika i aktivnosti;</p> <p>2.4. Pomaže u prezentaciji ministarskih politika i aktivnosti na profesionalan i efikasan način.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Zëdhënësi/ja i Ministrisë</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Spokesperson of the Ministry</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Portparol/ka Ministarstva</p>
<p>1. Zëdhënësi/ja i/e Ministrisë emërohet nga Ministri/ja dhe shërben si këshilltar/e kryesor/e profesional/e lidhur me çështje të komunikimit për ministrin/en dhe ministrinë;</p> <p>2. Detyrat e zëdhënësit/es të ministrisë janë si në vijim:</p>	<p>1. The Spokesperson of the Ministry shall be appointed by the Minister and shall serve as the main professional advisor on communication issues for the Minister and the Ministry;</p> <p>2. The duties of the Spokesperson of the Ministry are as follows:</p>	<p>1. Portparola/ku Ministarstva imenuje ministar/ka i služi kao glavni/a profesionalni/a savetnik/ca o pitanjima komunikacije za ministra/ku i ministarstvo;</p> <p>2. Dužnosti Portparola/ke Ministarstva su sledeće:</p>

<p>2.1. Siguron prezantimin medial të aktiviteteve zyrtare të ministrit/es dhe të ministrisë, brenda dhe jashtë vendit;</p> <p>2.2. Merr pjesë në përgatitjen e deklaratave dhe fjalimeve të ministrit/es dhe të ministrisë;</p> <p>2.3. Siguron që ministria të ofrojë ndihmën e nevojshme për prezantimin e përgjithshëm të politikave qeveritare së bashku me Udhëheqësin/en e ZKP të ministrisë dhe sipas nevojës edhe me zëdhënësin/en e Qeverisë.</p> <p>3. Zëdhënësi/ja i/e ministrisë do të punoj së bashku me ZKP në ministri dhe zëdhënësin/en apo zyrtarin/en përgjegjës të agjencisë vartëse për komunikim efektiv qeveritar me publikun</p>	<p>2.1. Ensures media coverage of official activities of the Minister and the Ministry, domestically and abroad;</p> <p>2.2. Takes part in preparation of statements and speeches of the Minister and of the Ministry;</p> <p>2.3. Ensures that the Ministry provides the necessary support for general presentation of government policies together with the Director of PCO of the Ministry and the Spokesperson of the Government, when appropriate.</p> <p>3. Spokesperson of the Ministry shall work together with the PCO within the Ministry and spokesperson or responsible officer of the subordinate agency for an effective government communication with the public.</p>	<p>2.1. Obezbeđuje medijsku prezentaciju zvaničnih aktivnosti Ministra/ke i Ministarstva, kako unutar tako i izvan zemlje;</p> <p>2.2. Učestvuje u pripremi izjava i govora Ministra/ke i Ministarstva;</p> <p>2.3. Obezbeđuje da Ministarstvo daje doprinos celokupnoj prezentaciji vladinih politika zajedno sa Rukovodiocem KJK ministarstva i, po potrebi, sa Portparolom/kom Vlade.</p> <p>3. Portparol/ka Ministarstva će raditi zajedno sa KJK u Ministarstvu i portparolom/kom ili odgovornim službenikom/com podređene Agencije na efektivnoj komunikaciji Vlade s javnošću</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Zëdhënësi/ja i/e Komunës</p> <p>1. Zëdhënësi/ja i/e komunës emërohet nga kryetari/ja i/e komunës dhe shërben si këshilltar/e kryesor/e profesional/e lidhur me çështje të komunikimit për kryetarin/en dhe komunën.</p> <p>2. Zëdhënësi/ja i/e komunës është përgjegjës/e për sigurimin e prezantimit medial të aktiviteteve zyrtare të kryetarit dhe komunës, brenda dhe jashtë vendit;</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Spokesperson of the Municipality</p> <p>1. The Spokesperson of the Municipality shall be appointed by the Mayor and shall serve as the main professional advisor on communication issues for the Mayor and the Municipality;</p> <p>2. Spokesperson of the Municipality is responsible to ensure media coverage of official activities of the Mayor and the Municipality, domestically and abroad;</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Portparol/ka Opštine</p> <p>1. Portparola/ku opštine imenuje gradonačelnik i služi kao glavni/a profesionalni/a savetnik/ca o pitanjima komunikacije za gradonačelnika/cu i opštinu;</p> <p>2. Portparol/ka Opštine odgovoran/na je za obezbeđivanje medijske prezentacije zvaničnih aktivnosti Gradonačelnika/ce i Opštine, kako unutar tako i izvan zemlje;</p>

<p>3. Zëdhënësi/ja i/e komunës do të punoj së bashku me njësinë/zyrtarin/en përgjegjës/e të komunës për komunikim, për komunikim efektiv me publikun.</p> <p>4. Zëdhënësi/ja i/e komunës bashkëpunon rregullisht me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për të koordinuar aktivitetet e përgjithshme të komunikimit.</p>	<p>3. Spokesperson of the Municipality shall work with the Municipal Unit/Official responsible for Public Communication, for effective communication with the public</p> <p>4. Spokesperson of the Municipality regularly cooperates with the Ministry of Local Government Administration to coordinate overall communication activities.</p>	<p>3. Portparol/ka Opštine će raditi zajedno sa Jedinicom/Službenikom odgovornim za javnu komunikaciju u Opštini, na efektivnoj komunikaciji s javnošću</p> <p>4. Portparol/ka Opštine redovno saraduje sa Ministarstvom administracije lokalne samouprave kako bi koordinirao opšte aktivnosti komunikacije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Funksionet e Zyrës për Komunikim me Publikun në Zyrën e Kryeministrit</p> <p>1. ZKP-ZKM është përgjegjëse për:</p> <p>1.1. Komunikimin me media dhe monitorimin e mediave;</p> <p>1.2. Planifikimin, koordinimin dhe komunikimin e politikave;</p> <p>1.3. Komunikimin me mediat e reja;</p> <p>2. Komunikimi me media dhe monitorimi i mediave përfshinë:</p> <p>2.1. Përgatitjen, shpërndarjen dhe arkivimin e njoftimeve dhe komunikatave për shtyp në gjuhët zyrtare;</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Functions of the Public Communication Office in the Office of the Prime Ministry</p> <p>1. PCO-OPM is responsible for:</p> <p>1.1. Communication with media and media monitoring;</p> <p>1.2. Planning, coordinating and communicating policies;</p> <p>1.3. Communication with new media;</p> <p>2. Communication with media, and media monitoring includes:</p> <p>2.1. Prepares, distributes and archives press releases and communications in official languages;</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Funkcije Kancelarije za javnu komunikaciju u Kancelariji Premijera</p> <p>1. KJK-KP odgovorna je za:</p> <p>1.1. Komunikaciju sa medijima i praćenje medija;</p> <p>1.2. Planiranje, koordinaciju i komunikaciju politika;</p> <p>1.3. Komunikaciju sa novim medijima;</p> <p>2. Komunikacija sa medijima i praćenje medija uključuju:</p> <p>2.1. Pripremu, distribuciju i arhiviranje obaveštenja i saopštenja za štampu na službenim jezicima;</p>

<p>2.2. Përgatitjen, shpërndarjen dhe arkivimin e fotografive dhe materialeve audio-vizuele të aktiviteteve kryesore të komunikimit të Kryeministrit/es, Zv.kryeministrave dhe Qeverisë;</p> <p>2.3. Organizimin e konferencave për shtyp;</p> <p>2.4. Planifikimin e intervistave të Kryeministrit/es dhe Zëvendëskryeministrave në media;</p> <p>2.5. Ofrimin e përgjigjeve në pyetjet e gazetarëve;</p> <p>2.6. Monitorimin dhe analizimin e raporteve të mediave për aktivitetet e Kryeministrit/es dhe Qeverisë në tërësi;</p> <p>3. Planifikimi, koordinimi dhe komunikimi i politikave përfshinë:</p> <p>3.1. Përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e planit vjetor të komunikimit duke marrë parasysh prioritetet që dalin nga Plani Vjetor i Punës së Qeverisë;</p> <p>3.2. Koordinimin e kalendarit javor të aktiviteteve të komunikimit të Qeverisë;</p> <p>3.3. Planifikimin e mbulimit medial për zbatimin e vendimeve të qeverisë, për vizitat shtetërore dhe konferencat ndërkombëtare të nivelit të lartë;</p>	<p>2.2. Prepares, distributes and archives photos and audio-visual materials of the main communication activities of the Prime Minister, Deputy Prime Ministers and Government;</p> <p>2.3. Organizations of press conferences;</p> <p>2.4. Planning interviews for the Prime Minister and Deputy Prime Ministers for the media;</p> <p>2.5. Providing answers to the questions of journalists;</p> <p>2.6. Monitoring and analysing media reports regarding activities of the Prime Minister and Government in general;</p> <p>3. Planning, coordinating and communicating policies includes:</p> <p>3.1. Preparing, implementing and monitoring the annual communication plan considering the priorities deriving from the Government Annual Work Plan;</p> <p>3.2. Coordinating the weekly calendar of government communication activities;</p> <p>3.3. Planning media coverage for the implementation of government decisions, on state visits and international high-level conferences;</p>	<p>2.2. Pripremu, distribuciju i arhiviranje fotografija i audio-vizuelnih materijala glavnih aktivnosti komunikacije Premijera/ke, Zamenika/ce premijera/ke i Vlade;</p> <p>2.3. Organizovanje konferencija za štampu;</p> <p>2.4. Planiranje intervjuja Premijera/ke i Zamenika/ce premijera/ke u medijima;</p> <p>2.5. Pružanje odgovora na pitanja novinara;</p> <p>2.6. Praćenje i analizu medijskih izveštaja o aktivnostima Premijera/ke i Vlade u celini;</p> <p>3. Planiranje, koordinacija i komunikacija politika uključuju:</p> <p>3.1. Pripremanje, sprovođenje i praćenje godišnjeg plana komunikacije uzimajući u obzir prioritete koji proizilaze iz Godišnjeg plana rada Vlade;</p> <p>3.2. Koordinaciju nedeljnog kalendara aktivnosti komunikacije Vlade;</p> <p>3.3. Planiranje medijskog pokrivanja za sprovođenje odluka Vlade, za državne posete i međunarodne konferencije na visokom nivou;</p>
--	--	--

<p>3.4. Planifikimin dhe koordinimin e fushatave informuese dhe vetëdijësuese për publikun lidhur me politikat prioritare të Qeverisë;</p> <p>3.5. Koordinimin e publikimit dhe promovimit të materialeve të ndryshme të Qeverisë;</p> <p>3.6. Koordinimin e punës në sigurimin e kontributeve të zyrtarëve të komunikimit të ministrive për përgatitjen e planeve të komunikimit në fazat e hershme të zhvillimit të politikave dhe legjislacionit;</p> <p>3.7. Komunikimin e aktiviteteve të konsultimeve, posaçërisht të takimeve publike dhe konsultimeve online përmes:</p> <p>3.7.1. thjeshtëzimit të mesazheve lidhur me qëllimin e legjislacionit/politikave të reja për ta bërë atë më të kuptueshëm për publikun dhe mediat;</p> <p>3.7.2. organizimit të konferencave për shtyp;</p> <p>3.7.3. informimit të gazetarëve në fillim të procesit të konsultimeve;</p> <p>3.7.4. rritjes së mbulimit medial të takimeve publike;</p>	<p>3.4. Planning and coordinating public information and awareness campaigns regarding the Government's priority policies;</p> <p>3.5. Coordinating the publication and promotion of various Government materials;</p> <p>3.6. Coordinating work on providing contribution of communication officers of the ministries for the preparation of communication plans in the early stages of policy and legislation development;</p> <p>3.7. Communication of consultation activities, particularly of public meetings and online consultations by:</p> <p>3.7.1. simplifying the messages regarding the purpose of new legislation/policies in order to make it more understandable for the public and the media;</p> <p>3.7.2. organizing press conferences;</p> <p>3.7.3. informing journalists at the beginning of the consultation process;</p> <p>3.7.4. increasing media coverage of public meetings;</p>	<p>3.4. Planiranje i koordinaciju kampanja informisanja i podizanja svesti javnosti u vezi sa prioritnim politikama Vlade;</p> <p>3.5. Koordinaciju objavljivanja i promovisanja različitih materijala Vlade;</p> <p>3.6. Koordinaciju rada na obezbeđivanju doprinosa službenika za komunikaciju Ministarstava za pripremu planova komunikacije u ranim fazama razvoja politika i zakonodavstva;</p> <p>3.7. Komunikaciju o aktivnostima konsultacija, posebno o javnim sastancima i online konsultacijama putem:</p> <p>3.7.1. pojednostavljivanja poruka u vezi sa ciljem novog zakonodavstva/novih politika kako bi ih učinili razumljivijim za javnost i medije;</p> <p>3.7.2. organizovanja konferencija za štampu;</p> <p>3.7.3. informisanja novinara na početku procesa konsultacija;</p> <p>3.7.4. povećanja medijskog pokrivanja javnih sastanaka;</p>
---	--	---

<p>3.7.5. shpërndarjen e njoftimeve për komentet e dala nga këto diskutime nëpërmjet rrjeteve sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit;</p> <p>3.7.6. prezantimit të raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike te mediat dhe publiku i gjerë;</p> <p>3.7.7. informimit të mediave dhe partnerëve kryesorë në progresin e zbatimit të legjislacionit/politikës së miratuar.</p> <p>4. Komunikimi me mediat e reja përfshinë:</p> <p>4.1. Përditësimin, sigurimin e qasjes dhe kredibilitetin e informatave në ueb-faqen zyrtare të institucionit;</p> <p>4.2. Përgatitjen dhe publikimin në uebfaqen e ZKM-së të aktiviteteve të komunikimit të Kryeministrit/es, Zëvendëskryeminstreve, Zyrës së Kryeministrit, që përfshinë:</p> <p>4.2.1. agjendën e aktiviteteve ditore;</p> <p>4.2.2. komunikatat për media;</p> <p>4.2.3. fjalimet;</p> <p>4.2.4. deklaratat dhe intervistat.</p>	<p>3.7.5. issuing notices regarding comments deriving from these discussions through social networks and other communication channels;</p> <p>3.7.6. presenting reports on the outcomes of public consultations to the media and the public;</p> <p>3.7.7. informing the media and the main partners on the progress of implementing the adopted legislation/policy.</p> <p>4. Communication with new media includes:</p> <p>4.1. Updating, providing access and credibility of the information on the official website of the institution;</p> <p>4.2. Preparing and publishing the communication activities of the Prime Minister, Deputy Prime Ministers, Office of the Prime Minister on the OPM's website which includes:</p> <p>4.2.1. agenda of daily activities,</p> <p>4.2.2. press releases,</p> <p>4.2.3. speeches,</p> <p>4.2.4. statements and interviews.</p>	<p>3.7.5. distribucije obaveštenja o komentarima proizašlim iz ovih diskusija putem društvenih mreža i drugih kanala komunikacije;</p> <p>3.7.6. predstavljanja medijima i javnosti izveštaja o rezultatima javnih konsultacija;</p> <p>3.7.7. informisanja medija i glavnih partnera o napretku sprovođenja usvojenog zakonodavstva/politike.</p> <p>4. Komunikacija sa novim medijima uključuje:</p> <p>4.1. Ažuriranje, obezbeđivanje pristupa i verodostojnost informacija na službenoj veb stranici institucije;</p> <p>4.2. Pripremanje i objavljivanje na veb stranici KP aktivnosti komunikacije, Premijera/ke, Zamenika/ce premijera/ke, Kancelarije Premijera, koje obuhvata:</p> <p>4.2.1. agendu dnevnih aktivnosti,</p> <p>4.2.2. saopštenja za medije,</p> <p>4.2.3. govore,</p> <p>4.2.4. izjave i intervjuue.</p>
--	---	---

<p>4.3. Publikimin dhe përditësimin e të gjitha vendimeve dhe dokumenteve tjera të aprovuara nga Qeveria apo Zyra e Kryeministrit në uebfaqen e ZKM-së;</p> <p>4.4. Menaxhimin e komunikimit të llogarisë zyrtare të Zyrës së Kryeministrit në rrjetet sociale;</p> <p>4.5. Menaxhimin e llogarisë elektronike zyrtare për komunikim me publikun;</p> <p>5. Zyra për Komunikim Publik në ZKM gjithashtu pranon dhe bën trajtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike si dhe për të dhënat e hapura</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Drejtori/esha i/e Zyrës për Komunikim Publik në ZKM</p> <p>1. Drejtori/esha i/e ZKP-ZKM është përgjegjës/e për:</p> <p>1.1. Menaxhimin e ZKP-ZKM për të siguruar mbështetje profesionale për Kryeministrin/en dhe zëdhënësin/en e Qeverisë;</p> <p>1.2. Udhëheqjen e Trupit Koordinues Qeveritar për Komunikimin me Publikun;</p>	<p>4.3. Publication and updating of all decisions and other documents approved by the Government or the Office of the Prime Minister on the OPM's website;</p> <p>4.4. Management of communication via official account of the Office of the Prime Minister in social networks;</p> <p>4.5. Management of e-mail account for communication with the public;</p> <p>5. The Public Communication Office in OPM also receives and conducts initial handling of requests for access to public documents, as well as for open data;</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Director of Public Communication Office within OPM</p> <p>1. Director of PCO-OPM is responsible for:</p> <p>1.1. Managing the PCO-OPM to ensure professional support for the Prime Minister and the Spokesperson of the Government;</p> <p>1.2. Leading the Government Coordination Body for Public Communication;</p>	<p>4.3. Objavljivanje i ažuriranje svih odluka i drugih dokumenata odobrenih od strane Vlade ili Kancelarije Premijera na veb stranici KP-a;</p> <p>4.4. Upravljanje komunikacije službenog naloga Kancelarije Premijera putem društvenih mreža;</p> <p>4.5. Upravljanje e-mail adresom za komunikaciju s javnošću;</p> <p>5. Kancelarija za javnu komunikaciju u KP takođe prihvata i vrši početnu obradu zahteva za pristup javnim dokumentima i otvorenim podacima;</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Direktor/ica Kancelarije za javnu komunikaciju u KP</p> <p>1. Direktor/ica KJK-KP odgovaran/na je za:</p> <p>1.1. Rukovođenje KJK-KP radi obezbeđivanja stručne podrške Premijeru/ki i Portparolu/ki Vlade;</p> <p>1.2. Rukovođenje Koordinacionog tela Vlade za javnu komunikaciju;</p>
--	--	---

<p>1.3. Sigurimin e përgatitjes së materialeve dhe njoftimeve për paraqitjet mediale të Kryeministrit/es, Zëvendëskryeministrave, Zyrës së Kryeministrit dhe zëdhënësit/es të Qeverisë, përmes koordinimit të aktiviteteve të zyrtarëve të komunikimit në organet e larta të administratës shtetërore të Kosovës, duke kërkuar nga ata të përgatisin plane komunikimi në bazë të planit vjetor të punës së ministrisë dhe që të ofrojnë kalendarë të aktiviteteve ministrore dhe informata mbështetëse;</p> <p>1.4. Përgatitjen e përgjigjeve, deklaratave dhe njoftimeve, të cilat i transmeton përmes zëdhënësit të Qeverisë;</p> <p>1.5. Krijimin e rrjetit të zyrtarëve të komunikimit, të cilët bashkëpunojnë dhe komunikojnë me publikun në situata të krizave.</p> <p>2. Drejtori/esha i/e ZKP-ZKM mund të zëvendësojë Zëdhënësin/en e Qeverisë në mungesë të tij/saj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Funksionet e Zyrës për Komunikim me Publikun në ministri</p> <p>1. ZKP në ministri ka përgjegjësitë në vijim:</p>	<p>1.3. Ensuring preparation of materials and notices for media appearances for the Prime Minister, Deputy Prime Ministers, Office of the Prime Minister and Spokesperson of the Government, by coordinating activities of communication officers in high level bodies of state administration of Kosovo, requiring them to prepare the communication plans, based on the annual work plan of the ministry, and to provide the ministerial activity schedule and supporting information;</p> <p>1.4. Preparing responses, statements and notices and transmitting them through the Spokesperson of the Government;</p> <p>1.5. Establishing the network of communication officers, who cooperate and communicate with the public in situations of crises.</p> <p>2. Director of PCO-OPM may replace the Spokesperson of the Government in case of his absence.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Functions of the Public Communication Office in the Ministry</p> <p>1. PCO in the Ministry has the following responsibilities:</p>	<p>1.3. Obezbeđivanje pripremanje materijala i obaveštenja o medijskim nastupima Premijera/ke, Zamenika/ce premijera/ke, Kancelarije Premijera i Portparola/ke Vlade, putem koordinacije aktivnosti službenika/ce za komunikaciju u najvišim organima državne administracije na Kosovu, tražeći od njih da pripreme planove komunikacije na osnovu godišnjeg plana rada Ministarstva i da obezbede kalendare ministarskih aktivnosti i prateće informacije;</p> <p>1.4. Pripremu odgovora, izjava i obaveštenja, koje prenosi preko Portparola/ke Vlade;</p> <p>1.5. Uspostavljanje mreže službenika za komunikaciju, koji sarađuju i komuniciraju s javnošću u kriznim situacijama.</p> <p>2. Direktor/ica KJK-KP može da zameni Portparola/ku Vlade u njegovom/njenom odsustvu.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Funkcije Kancelarije za javnu komunikaciju u Ministarstvu</p> <p>1. KJK u Ministarstvu ima sledeće odgovornosti:</p>
--	---	---

<p>1.1. Ofron përkrahje profesionale për ministrin/en, ministrinë, zëdhënësin/en e ministrisë, duke ofruar këshilla për efektivitet të prezantimit të politikave;</p> <p>1.2. Bën përgatitjen, mirëmbajtjen dhe zbatimin e planit të komunikimit në bazë të planit të punës së ministrisë, duke zbatuar teknika efektive të komunikimit;</p> <p>1.3. Ofron për ZKP-ZKM kalendarin javor të aktiviteteve të komunikimit të ministrit/es dhe ministrisë;</p> <p>1.4. Bashkëpunon me zëdhënësin/en e ministrisë për organizimin e konferencave për shtyp dhe intervistave;</p> <p>1.5. Përgatit dhe shpërndan komunikata për shtyp, deklaratat, raporte dhe publikime tjera për publikun;</p> <p>1.6. Përgatit, shpërndan dhe arkivon fotografitë dhe materialet audio-vizuele të aktiviteteve kryesore të ministrisë;</p> <p>1.7. Merr pjesë në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit, përmes zhvillimit dhe prezantimit të planeve të komunikimit, si dhe komunikimit të takimeve publike dhe konsultimeve online me publikun;</p>	<p>1.1. Provides professional support for the Minister, Ministry, and Spokesperson of the Ministry by providing advices on effectiveness of policy presentation;</p> <p>1.2. Prepares, maintains and implements the communication plan based on the work plan of the Ministry by applying effective communication techniques;</p> <p>1.3. Provides PCO – OPM with the weekly schedule of communication activities of the Minister and of the Ministry;</p> <p>1.4. Cooperates with the Spokesperson of the Ministry for organizing press conferences and interviews;</p> <p>1.5. Drafts and issues press releases, statements, reports and other publications for the public;</p> <p>1.6. Prepares, distributes and archives photos and audio-visual materials of the main activities of the Ministry;</p> <p>1.7. Participates in the process of drafting policies and legislation by developing and presenting communication plans, as well as communicating public meetings and online consultations with the public;</p>	<p>1.1. Pruža profesionalnu podršku Ministru/ki, Ministarstvu, Portparolu/ki Ministarstva, pružajući savete o efikasnosti prezentacije politika;</p> <p>1.2. Priprema, održava i sprovodi plan komunikacije na osnovu plana rada Ministarstva, sprovodeći efektívne tehnike komunikacije;</p> <p>1.3. Pruža KJK-KP nedeljni kalendar aktivnosti komunikacije Ministra/ke i Ministarstva;</p> <p>1.4. Sarađuje sa Portparolom/kom Ministarstva za organizovanje konferencija za štampu i intervjuja;</p> <p>1.5. Priprema i distribuira saopštenja za štampu, izjave, izveštaje i druge publikacije za javnost;</p> <p>1.6. Priprema, distribuira i arhivira fotografije i audio-vizuelne materijale glavnih aktivnosti Ministarstva;</p> <p>1.7. Učestvuje u procesu izrade politika i zakonodavstva, putem razvoja i predstavljanja planova komunikacije, kao i komunikacija javnih sastanaka i online konsultacija s javnošću;</p>
--	--	--

<p>1.8. Koordinon me ZKP-ZKM zhvillimin e fushatave informuese dhe vetëdijësuese për politikat prioritare të ministrisë;</p> <p>1.9. Raporton në ZKP-ZKM për zbatimin e planit vjetor të komunikimit çdo tre muaj;</p> <p>1.10. Përditëson, siguron qasjen dhe kredibilitetin e informatave në ueb-faqen zyrtare të ministrisë dhe menaxhon me llogarinë elektronike zyrtare për komunikim me publikun;</p> <p>1.11. Menaxhon komunikimin e ministrisë në llogarinë zyrtare të institucionit në rrjetet sociale;</p> <p>1.12. Ndihmon në përditësimin e portalit shtetëror;</p> <p>1.13. Pranon dhe shqyrton kërkesat fillestare për qasje në dokumente publike si dhe për të dhënat e hapura;</p> <p>1.14. Kryen të gjitha përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Udhëheqësi/ja i/e Zyrës së Komunikimit Publik të ministrisë</p> <p>1. Udhëheqësi/ja i/e ZKP të ministrisë është përgjegjës për:</p>	<p>1.8. Coordinates with PCO–OPM the development of information and awareness campaigns on priority policies of the Ministry;</p> <p>1.9. Reports to PCO – OPM on the implementation of communication plans on quarterly basis;</p> <p>1.10. Updates, ensures access and the credibility of information in the official website of the Ministry and manages the email account for public communication;</p> <p>1.11. Manages communication of the Ministry through the official account of the Institution in social networks;</p> <p>1.12. Assists in updating the state portal;</p> <p>1.13. Receives and examines initial requests for access to public documents, as well as open data;</p> <p>1.14. Fulfils all responsibilities set forth in the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Head of the Public Communication Office of the Ministry</p> <p>1. Head of the PCO of the Ministry is responsible for:</p>	<p>1.8. Koordinira sa KJK-KP razvoj kampanja informisanja i podizanja svesti za prioritete politike Ministarstva;</p> <p>1.9. Izveštava KJK-KP o sprovođenju godišnjeg plana komunikacije svaka tri meseca;</p> <p>1.10. Ažurira, obezbeđuje pristup i verodostojnost informacija na zvaničnoj veb stranici ministarstva i upravlja e-mail adresom za komunikaciju s javnošću;</p> <p>1.11. Upravlja komunikacijom Ministarstva putem službenog naloga institucije na društvenim mrežama;</p> <p>1.12. Pomaže u ažuriranju državnog portala;</p> <p>1.13. Prima i razmatra početne uslove za pristup javnim dokumentima, kao i za otvorene podatke;</p> <p>1.14. Izvršava sve odgovornosti utvrđene važećim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Rukovodilac Kancelarije za javnu komunikaciju u Ministarstvu</p> <p>1. Rukovodilac KJK ministarstva odgovoran/na je za:</p>
---	--	--

